

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti normativ që paraqitet për shqyrtim dhe miratim ka për synim një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndryshimi me akt normativ ka si qëllim dhënien e një ndihme, me karakter të përhershëm të gjithë personave që kanë humbur pjesëtarët e familjes nga fatkeqësia natyrore, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është hartuar si akt normativ me fuqinë e ligjit, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e nenit 101 të Kushtetutës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin për marrjen e masave të emergjencës për shkak të “fatkeqësisë natyrore”, të shpallur si e tillë me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Pas tërmetit 6.4 të shkallës *Riher* që goditi Shqipërinë, në datën 26.11.2019, Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë, të cilat janë edhe qarqet më të prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Të ndodhur në kushtet e emergjencës civile, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në kuadër të marrjes së masave imediate për rehabilitimin njerëzor të familjarëve të dëmtuar materialisht, por akoma më shumë edhe të rënduar shpirtërisht,

proponohet një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Akti normativ synon shtimin e një dispozite me efekt të menjëhershëm dhe të përkohshëm që parashikon trajtimin e veçantë financiar të personave që kanë humbur familjarët e tyre si pasojë e tërmetit të ndodhurnë datën 26.11.2019. Kjo dispozitë për trajtimin e veçantë financiar krijon mundësinë ligjore për dhënien e një ndihmë me karakter të përhershëm për të gjithë personat që kanë humbur pjesëtarët e familjes së tyre nga fatkeqësitë natyrore.

Konkretisht, në dispozitën e shtuar (neni 51/1/a) nëpërmjet këtij akti normativ përcaktohen dy kategori personash përfitues. 1) Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes dhe 2) personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes. Për secilën prej këtyre kategorive parashikohet një trajtim i ndryshëm, sipas dispozitës përkatëse, si vijon:

“Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes si pasojë e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, përfitojnë trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social, ndërsa personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë deri në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.

Pensionistët, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë vetëm trajtimin në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.”

Siç vihet re të parët që përfitojnë trajtim financiar në masën e tetëfishit të pensionit social (afërsisht 60 000 lekë në muaj) janë shtetasit që aktualisht përfitojnë pension sipas ligjit nr.7703 datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në kushtet kur këta pensionistë kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, atëherë do të përfitojnë si të gjithë personat e tjerë në këto kushte një trajtim në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social (afërsisht 100 000 lekë në muaj).

Ky përfitim, pra trajtimi i veçantë financiar do të jepet individualisht me vendim të Këshillit të Ministrave. Referuar akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe të statusit të Kryeministrit si kryetar i Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, është pikërisht Kryeministri që do të propozojë projektvendimet përkatëse. Komisioni përkatës harton listën e të gjithë të propozuarve që kanë dokumentacionin e saktë dhe vendimi bëhet me propozimin e Kryeministrit.

Me këtë shtesë realizohet qëllimi për t'i dhënë një ndihmë me karakter të përhershëm dhe nuk ngatërrohet me skemën e pensionit duke mos e prekur atë dhe njëkohësisht i lejohej të punojë dhe të kontribuojë për pensionet nga skema e detyrueshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Akti normativ është hartuar në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Konkretisht, në dispozitën e shtuar (neni 51/1/a) nëpërmjet këtij akti normativ përcaktohen dy kategori personash përfitues. 1) Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes dhe 2) personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes. Për secilën prej këtyre kategorive parashikohet një trajtim i ndryshëm, sa më poshtë vijon, sipas dispozitës përkatëse:

“Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes si pasojë e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, përfitojnë trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social, ndërsa personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë deri në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.

Pensionistët, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë vetëm trajtimin në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.

Trajtimi i veçantë financiar caktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.”.

Siç vihet re të parët që përfitojnë trajtim financiar në masën e tetëfishit të pensionit social (afërsisht 60 000 lekë në muaj) janë shtetasit që aktualisht përfitojnë pension sipas ligjit nr.7703 datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në kushtet kur këta pensionistë kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, atëherë do të përfitojnë si të gjithë personat e tjerë në këto kushte një trajtim në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social (afërsisht 100 000 lekë në muaj).

Ky përfitim, pra trajtimi i veçantë financiar do të jepet individualisht me vendim të Këshillit të Ministrave. Referuar akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe të statusit të Kryeministrit si kryetar i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, është pikërisht Kryeministri që do të propozojë projektvendimet përkatëse. Komisioni përkatës harton listën e të gjithë të propozuarve që kanë dokumentacionin e saktë dhe ndërsa vendimi bëhet me propozim të Kryeministrit.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ashtu si dhe për kategoritë e tjera përfituese sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe trajtimi i veçantë financiar për kategorinë e përfituesve sipas këtij aktit normativ do të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ do të ketë efekte në buxhetin e shtetit që mund të llogariten përafërsisht 10 përfitues.

IX. HYRJA NË FUQI E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ do të hyjë në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”. Njëkohësisht i përcillet për miratim Kuvendit të Shqipërisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE